




FUNKSIONALITETE NDIHMËSE NË UB ONLINE



- Keni harruar fjalëkalimin
- Kutia postare e UB Online
- Harta e degëve dhe ATM-ve të bankës



Keni harruar fjalëkalimin

Si të hyni? → *Faqja e Hyrjes në UB Online > Kam Harruar Fjalëkalimin*



Këtu vendosni emrin e përdoruesit dhe datën e lindjes.

Në adresën e-mail do t'ju vijë një kod aktivizimi, të cilin do ta vendosni dhe klikoni Paraqit. Më pas ju shfaqet një ekran ku ju duhet të vendosni fjalëkalimin e ri. Fjalëkalimi i ri duhet të përmbajë: shkronja kapitale, shkronja të vogla, numër dhe simbol.



E njëjta procedurë vlen edhe për të ndryshuar emrin e përdoruesit.

***Ndryshimi i detyruar i fjalëkalimit** duhet bërë patjetër në rastet kur:


- Përdoruesi hyn në shërbimin online për herën e parë
- Koha e përdorimit të fjalëkalimit ekzistues ka skaduar

***Kodi i Verifikimit** është një kod unik me një përdorim. Është kod detyrues që dërgohet në kontaktet që përdoruesi ka të regjistruara në bankë. Ju duhet të vendosni kodin e verifikimit për të plotësuar disa procese. Ju mund të ri-kërkoni një kod në rast se kodi i kërkuar ka skaduar.


Kutia postare e UB Online

Nëpërmjet kutisë postare ju keni mundësinë të komunikoni me bankën për çdo nevojë apo pyetje. Kutia e mesazheve është e ndarë në tre kanale dhe ju mund të zgjidhni një nga këto kanale për të nisur komunikimin.


Si të hyjni? → *Menu > Kutia Postare*




Kutia e Mesazheve → Në kutinë e mesazheve ju mund të gjeni mesazhet që ju kanë ardhur, mesazhet e dërguara dhe të fshira nga ju. Për t'i shkruar mesazh bankës ju duhet të klikoni "Shkruaj mesazh". Keni mundësi të bashkëngjisni edhe dokumentat e transfertave që dëshironi t'i dërgoni bankës me një madhësi deri në 10 MB.




Sinjalizime



Në këtë seksion ju shihni të gjitha sinjalizimet për veprimet që keni kryer në UB Online.



Po të klikoni mbi një nga transaksionet ju shfaqen detajet e këtij transaksioni.




Njoftime > Tek njoftimet ju keni mundësi të shihni të gjitha njoftimet që banka nis në lidhje me kushte të ndryshme apo oferta.



Harta e Degëve/ATM-ve të bankës

Duke përdorur këtë opsion ju mund të gjeni vendodhjen e një dege ose ATM-je.

Harta ATM/Degë → E gjeni në faqen hyrëse ikonën e vendodhjes në fund të faqes



Ose nëse jeni brenda në platformë e gjeni **Menu > Harta ATM/Degë**. Kur hyni brenda do t'ju dalë një tabelë që ju kërkon të lejoni sistemin të dijë vendndodhjen tuaj. Nëse kornfirmoni ju shfaqet një hartë.



Këtu klikoni degën apo ATM-në më të afërt dhe do t'ju dalin degët me ikona. Aty mund të zgjidhni vendndodhjen që ju dëshironi.

